

	<p style="text-align: center;">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;">Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 125 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 të MMPH-së, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, nenit 17 pika “d” të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 15 pika “d” të Statutit të Komunës së Prishtinës 01nr.110-391, si dhe duke vendosur sipas kërkesës/ankesës 05 Nr. 070/01-308149/19 dt. 19.12.2019, të aplikuesit Fitim Vërtopi nga Prishtina, rr. “Isa Kastrati” nr. 75 në Prishtinë, përmes së cilës është përgjigjur në shkresën e referuar dhe ka kërkuar publikimin e komenteve/kundërshtimeve të tij në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 02.03.2020, merr këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR PUBLIKIMIN E KOMENTEVE NË
FAQEN ZYRTARE TË INTERNETIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

- I. MIRATOHET** kërkesa/ankesa 05 Nr. 070/01-308149/19 dt. 19.12.2019, në emër të aplikuesit Fitim Vërtopi nga Prishtina, për publikimin e komenteve/kundërshtimeve të tij në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, të paraqitura me datë 06.07.2018, në procedurën e qëndrimit të “Njoftim Publik” në periudhën kohore prej 26.07.2018 deri më 09.08.2018, i vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 350/02-0175425/18 dt. 19.07.2018.
- II. PUBLIKOHEN** komentet/kundërshtimet në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, të paraqitura: a) përmes postës elektronike të datës 06.07.2018, në procedurën e qëndrimit të “Njoftim Publik” në periudhën kohore prej 26.07.2018 deri më 09.08.2018, b) përmes shkresës “Kërkesë për te informuar per lejen ndërtimore dhe kushtet ndërtimore për investitorin "Albing-BE" për projektin në Lagjen e Muhaxhereve", me referencë 05 Nr. 354/01-278561/19/1 dhe 05 Nr. 354/01-278561/19/2 dt. 12.11.2019 dhe c) përmes shkresës “Përgjigje ne shkresen e juaj te dates 19.11.2019 dhe kerkese per publikim te kundërshtimeve/komenteve te mija te dates 06 korrik 2018”, me referencë 05 Nr. 070/01-308149/19 dt. 19.12.2019, të aplikuesit Fitim Vërtopi nga Prishtina, në dhe lidhur me procedurën e shqyrtimit të kërkesës 05 Nr. 350/02-0175425/18 dt. 19.07.2018.
- III.** Publikimi i komenteve/kundërshtimeve nga paragrafi I. i këtij vendimi do të bëhet menjëherë pas miratimit të kërkesës së referuar, me përmbajtje të njëjtë.

A r s y e t i m

Aplikuesi Fitim Vërtopi nga Prishtina, me kërkesën “Përgjigje ne shkresen e juaj te dates 19.11.2019 dhe kerkese per publikim te kundërshtimeve/komenteve te mija te dates 06 korrik 2018”, me referencë 05 Nr. 070/01-308149/19 dt. 19.12.2019, ka kërkuar nga kjo drejtori, publikimin në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, të komenteve/kundërshtimeve të paraqitura: a) përmes postës elektronike të datës 06.07.2018, në procedurën e qëndrimit të “Njoftim Publik” në periudhën kohore prej 26.07.2018 deri më 09.08.2018, b) përmes shkresës “Kërkesë për te informuar per lejen Ndërtimore dhe kushtet ndërtimor:e për investitorin "Albing-BE" për projektin në Lagjen e Muhaxhereve", me referencë 05 Nr. 354/01-278561/19/1 dhe 05 Nr. 354/01-278561/19/2 dt. 12.11.2019 dhe c) përmes shkresës “Përgjigje ne shkresen e juaj te dates 19.11.2019 dhe kerkese per publikim te kundërshtimeve/komenteve te mija te dates 06 korrik 2018”, me referencë 05 Nr. 070/01-308149/19 dt. 19.12.2019, në dhe lidhur me procedurën administrative të shqyrtimit të kërkesës 05 Nr. 350/02-0175425/18 dt. 19.07.2018, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e

dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, në lokacionin e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij akti.

Me kërkesën 05 Nr. 070/01-308149/19 dt. 19.12.2019, aplikuesi ka prezantuar kopjen e email-it/komenteve të dërguara në adresat zyrtare elektronike: nazife.krasniqi@rks-gov.net dhe mimoza.prestreshi@rks-gov.net, me datë 06.07.2018 (në sistemin e email-it zyrtar figuron data 06.08.2018).

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të kërkesës së lartcekur, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, dhe të dosjes së lëndës 05 Nr. 354/01-278561/19/1 dhe 05 Nr. 354/01-278561/19/2 dt. 12.11.2019, dhe 05 Nr. 350/02-0175425/18 dt. 19.07.2018, ka konstatuar si në vijim:

- Me shkresën zyrtare "Informim", me referencë 05 Nr. 354/01-278561/19/1 dhe 05 Nr. 354/01-278561/19/2 dt. 12.11.2019, të datës 19.11.2019, bazuar në kërkesën e parashtruesit Fitim Vertopi nga Prishtina, kjo drejtori ka informuar të njëjtin se me aktin administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore", 05 Nr. 350/02-0175425/18/2 dt. 18.07.2019, ka caktuar kushtet ndërtimore për parcelat kadastrale nr. 2596-2, 2597-0, 2598-1, 2598-2, 2598-3, 2598-4, 2598-5, 2598-6, 2599-2, 6877-3, 6878-0, 6880-0 dhe 6882-1 ZK Prishtinë, me trajtim me këmbim edhe të pjesës së parcelës kadastrale nr. 7748-0 ZK Prishtinë, me pronar/posedues "P.SH. Rrugët KK Prishtinë, të shtrira në kuadër të parcelës ndërtimore të bllokut urban "b_17", të nëntërësisë "B-4", të tërësisë "B" të Planit Rregullues "Muhaxhirët" dhe të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë. Po ashtu, është informuar se në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për caktim të kushteve ndërtimore, të lartshënuar, në adresën elektronike të zyrtarit përgjegjës të lëndës, në periudhën kohore të qëndrimit të njoftimit publik (26.07.2018 deri më 09.08.2018), i vendosur në hapësira të dukshme dhe frekuentuese të lokacionit dhe rrethinës në diametër prej 50 m, për të njoftuar publikun me synimet e pronarëve dhe investitorit konform nenit 18 të Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në pikën 1.2 dhe 1.2.2 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, nuk është pranuar asnjë koment apo ankesë tjetër, përveç një komenti nga Lulzim dhe Ibrahim Sejdiu nga Prishtina, ku përmes përgjigjes së publikuar në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, të njëjtit janë informuar sipas kërkesës së tyre;

- Aplikuesi Fitim Vertopi nga Prishtina, me kërkesën në trajtim, me referencë 05 Nr. 070/01-308149/19 dt. 19.12.2019, është përgjigjur në shkresën e referuar në paragrafin paraparak dhe ka kërkuar nga kjo drejtori, publikimin e komenteve/kundërshtimeve në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, të dhëna me datë 06.07.2018 (në sistemin e email-it zyrtar figuron data 06.08.2018), në procedurën e qëndrimit të "Njoftim Publik" në periudhën kohore prej 26.07.2018 deri më 09.08.2018, i vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 350/02-0175425/18 dt. 19.07.2018, në emër të Bajram Llapashtica, Nexhat Bytyqi, Blerim Gashi, Ilaz Shehu, Shoqata për Shërbime Edukative dhe Kulturore Bregu i Diellit, Lumnije Jashari, Shukrije Potera, Hanife Mema, Nazmije Gashi, Sanije Islami, Ismail Potera, Mevlude Potera dhe "Albing-B" shpk nga Prishtina, me investitor "Albing-B" shpk, me seli në Prizren, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste në kuadër të parcelës ndërtimore të bllokut urban "b_17", të nën tërësisë "B-4", të tërësisë "B" të Planit Rregullues "Muhaxhirët" dhe të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht në kompleksin e formuar nga parcelat kadastrale nr. 2596-2, 2597-0, 2598-1, 2598-2, 2598-3, 2598-4, 2598-5, 2598-6, 2599-2, 6877-3, 6878-0, 6880-0 dhe 6882-1 ZK Prishtinë, me trajtim me këmbim edhe të pjesës së parcelës kadastrale nr. 7748-0 ZK Prishtinë, me pronar/posedues "P.SH. Rrugët KK Prishtinë, duke i bashkëngjitur kopjen fizike të kundërshtimeve/komenteve të përcjella në adresat elektronike nazife.krasniqi@rks-gov.net dhe mimoza.prestreshi@rks-gov.net, me datë 06.07.2018 (në sistemin e email-it zyrtar figuron data 06.08.2018).

Zyrtari përgjegjës i lëndës, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresës/kopjes së kundërshtimeve/komenteve, duke verifikuar adresën në shkresën elektronike (kopjen fizike të email-it) në raport me sistemin e postës elektronike zyrtare, ka konstatuar se pala ka shënuar gabim adresën elektronike të zyrtares përgjegjëse të lëndës, në vend të nazife.i.krasniqi@rks-gov.net, është shënuar nazife.krasniqi@rks-gov.net, e cila adresë ka rezultuar të jetë e një zyrtareje në Komunën e Kaçanikut. Poashtu, nga ushtruesja e detyrës së udhëheqëses së sektorit (adresa e së cilës gjithashtu ka qenë e shënuar në njoftimin publik) nuk është vërejtur që adresa elektronike e referuar, nuk është shënuar saktë.

Andaj, kjo drejtori, duke u bazuar në kërkesën e palës, konstatimet e lartshënuara dhe në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht në nenin 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 të MMPH-së, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shpërndarjen e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-re dhe të II-të të ndërtimeve, vendosi që të miratojë kërkesën e palës dhe të bëjë publikimin e komenteve kundërshtimeve në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, menjëherë pas miratimit të kërkesës së njëjtë.

Bazuar në konstatimet e lartshënuara, u vendos si në dispozitiv të vendimit.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

Ky vendim u printua në 7 (shtatë) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesit, Drejtorisë së Administratës/Sektorit për Teknologji Informative, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05 Nr. 350/02-0175425/18/2 dt. 19.07.2018, 05 Nr. 070/01-308149/19 dt. 19.12.2019 dhe 05 Nr. 354/01-278561/19/1 dt. 12.11.2019.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 070/01-308149/19 DT. 02.03.2020**

Zyrtari,
Nazife Krasniqi



U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Borisha Prestreshi



Per: Ardian Olluri
Drejtor
Drejtoria e Urbanizmit
Komuna e Prishtines



Prej: Fitim Vertopi
Qytetar
Prishtine

Lenda: **Kerkese per te informuar per lejen ndertimore dhe kushtet ndertimore per Investitorin 'Albing - BE' per projektin ne Lagjen e Muhaxhereve**

Data: 12 nentor 2019

I referohem Vendimit per dhenien e kushteve ndertimore per Investitorin 'Albing - B', te dates 18.07.2019 dhe Lejen e rrenimit ne zonen e caktuar te projektit ne fjale.

Si qytetar i interesuar dhe i prekur drejtperdrejte ne realizimin e ketij Projekti, nepermjet e-mailit, kam ofruar mendimet e mija dhe kundershimitet qe poqese fillon realizimi i ndertimit ne parcelat ku jane dy shtepite tona dhe rrezikohet struktura por edhe siguria nga dhenia e lejes ndertimore Investitorit te potencuar me larte do te kundershtoje ligjerisht dhe do te ndjeket penalisht cdo person ose zyrtar publik ose person fizik ose person juridik per demin qe mund te na shkaktohet nga ngjarjet ne dy shtepite tona per shkak te mungeses se sigurise ose rrezikimit te strukture.

Ne vendimin per dhenien e kushteve ndertimore ceken kundershimitet e Zt. Ibrahim Sejdiu dhe Zt. Lulzim Sejdiu mirepo **nuk ceken edhe kundershimitet e mija qe kam dorezuar me email zyrtareve te Drejtorise se Urbanizmit** ne kohen kur zyrtaret pergjegjes komunal te Drejtorise se Urbanizmit kane vendosur Shpallje ne Lagje. Vetvetiu kjo eshte nje tregues ligjor qe Drejtoria e Urbanizmit te Komunes se Prishtines **eshte duke e favorizuar Investitorin** duke e fshehur informacionin ne Vendimin e saj te dates 18.07.2019.

Deri me daten 12 nentor 2019, ne portalin e Drejtorise se Urbanizmit, nuk ka informacion se eshte leshuar Leja ndertimore per Investitorin 'Albing - B'.

Megjithate, nese eshte leshuar Leja Ndertimore, si pale e interesuar kerkoje te me ofroni Kopjen Komplete te Lejes Ndertimore me te gjitha dokumentacionin perkates (*duke perfshire edhe marreveshjet e Investitorit me Banoret*) ngase Investitori ka marre kushtet ndertimore per te realizuar projektin kurse ne **menyre te paligjshme ka bere edhe Marreveshje edhe me familjet Krasniqi dhe familjet Gashi** qe rrethojne 2 shtepite tona **por qe ligjerisht nuk jane pjese e projektit dhe te potencuar ne Vendimin per Kushtet Ndertimore** i leshuar per firmen 'Albing - BE' dhe ne Lejen per Rrenim. Pra, zyrtarisht dhe ligjerisht keto dy familje nuk jane pjese e projektit.

Largimi i ketyre dy familjeve (*kane leshuar shtepite e tyre me daten 04 nentor 2019*) dhe **financimi i qirase se tyre nga Investitori 'Albing - BE'** eshte bere ne kundershitim me Vendimin per Dhenien e Kushteve Ndertimore dhe me cdo akt tjeter ligjor te ligjeve ne fuqi dhe ky veprim i investitoreve eshte bere me qellim te caktuar qe te ushtrojne presion ilegal dhe psikologjik ndaj familjes sone qe edhe ne te i nenshtrohemi dhe te ofrojme 2 shtepite tona per te hyr ne projektin e tyre - kjo nuk do te ndodh pervec pranimit dhe negociimit te Ofertes sone nga Investitori qe une si pale e interesuar i kam derguar zyrtarisht Investitorit gjate muajit Shtator 2019.

Ne cdo kohe kur te leshohet Leja ndertimore per Investitorin e lartepemendur, Drejtoria e Urbanizimit, eshte e obliguar ligjerisht si pale te interesuar te ofroje KOPJEN KOMplete te Lejes Ndertimore.

Gjitheashtu, Drejtoria e Inspeksionit, duhet te vezhgoje rrenimin ngase ka pjese ne ate hapesire ku eshte duke u realizuar punimet e rrenimit **qe nuk jane vendosur Rrethojat dhe rrezikohen shtepite tona** por edhe shtepite tjera perreth per shkak mungeses se ndriqimit elektrik dhe akteve tjera te paligjshme qe mund te behen nga palet e treta me qellime te caktuara ndaj familjes sone.

Ne qoftese se **ndodh prej ketij momenti ndonje akt ndaj familjes sone; ndaj anetareve te familjes sone; ndaj 2 shtepive tona ose ndaj shtepive dhe familjeve tjera per shkak mungeses se sigurise**, ashtu sic e pershkrova me larte atehere te gjitha **personat e involvuar do te konsiderohen pergjegjes per ngjarjen e tille dhe do te ndjeken penalisht nga institucionet publike / gjyqesore te Republikes se Kosoves dhe do bejne kompenzimin e demit material dhe financiar.**

Pres qe kur te leshoni Lejen Ndertimore per Investitorin 'Albing - B' (*nuk ka informacione nga portali i Komunes se Prishtines qe eshte leshuar kjo leje zyrtarisht*) qe te me njoftoni zyrtarisht dhe te me ofroni Kopjen Komplete te Lejes Ndertimore ngase **prekem si pale e interesuar nga realizimi i ketij Projekti** per te konstatuar ligjerisht nese kjo Leje Ndertimore eshte dhene ne pajtim me te gjitha ligjet ne fuqi ne Republikën e Kosoves nga zyrtaret pergjegjes te Komunes se Prishtines.

Gjitheashtu, ne afatin ligjor pres pergjigje ligjore me shkrim nga Drejtoria e Urbanizimit **duke potencuar saktesisht 'bazen ligjore' te ligjeve ne fuqi nese veprimet e Investitorit 'Albing - B' jane ne pajtim me kushtet ndertimore dhe ne pajtim me te gjitha aktet ligjore ne baze te pershkrimtit te rastit si me larte dhe per cdo rrezik dhe dem qe i shkaktohet familjes sone do te pergjigjen ligjerisht si zyrtaret e Departamentit te Urbanizimit por edhe te gjitha personat tjere te involvuar te Investitorit.**

Cdo refuzim per ofrimin e kopjes se lejes ndertimore per Investitorin 'Albing - B' eshte i paligjshem dhe kunderligjor dhe i njejti refuzim do te klasifikohet si abuzim me detyren dhe pushtetin publike duke e konsideruar te njejten si akt te denueshem qe do te njoftohen organet me te larta publike dhe gjyqesore.

Per cdo paqartesi lidhur me permbatjen e kesaj Kerkese, ju lutem, mos hezitoni te me kontaktoni ne kete numer telefoni: 045 232 002 ose ne emailin: fitimv@gmail.com

Me nderime,

Cc: Adonis Tahiri, Drejtor i Inspeksionit - Komuna e Prishtines

Nazife Krasniqi, Arkitekthe, Drejtoria e Urbanizimit, Komuna e Prishtines

Mimoza Berisha - Prestreshi, U.D e Sektorit, Drejtoria e Urbanizimit, Komuna e Prishtines

Per: Nazife Krasniqi

Zyrtare

Drejtoria e Urbanizmit

Komuna e Prishtines

Prej: Fitim Vertopi

Qytetar

Prishtine



Lenda: **Pergjigje ne shkresen e juaj te dates 19.11.2019 dhe kerkese per publikim te kundershtimeve/komenteve te mija te dates 06 korrik 2018**

Data: 19 dhjetor 2019

Ju falenderoj per pergjigje konkrete qe konfirmoni qe per shkaqe ligjore dhe pronesore, familjet Krasniqi, Gashi dhe Zeneli por edhe familjet tjera qe rrethojne parcelen gjegjesisht shtepine tone nuk do te bashkengjiten Projektit aktual te firmes 'Albing - B', qe kane marre Vendimin per kushtet ndertimore, e dates 18.07.2019, e leshuar nga ana e Drejtorise se Urbanizmit.

Une pata kerkuar nga Komuna e Prishtines, qe te me ofrohet kopja e lejes se rrenimit per te konstatuar nese kjo cfare konstatori eshte e vertete ose jo **por nje kopje e lejes se rrenimit nuk me eshte ofruar dhe kjo konsiderohet shkelje ligjore e Ligjit per Qasje ne Dokumente Publike** nga ana e Drejtorise se Urbanizmit dhe Drejtorise se Inspeksionit.

Natyrisht, se kur te jepet leja ndertimore – do te shiqoje portalin e Komunes se Prishtines dhe poqese konstatoje se fillon projekti ne kufirin e dy shtepive tona do te kundershtoj ligjshem sic kam theksuar me e-mail te dates 06 korrik 2018, ora 13.25 pm, drejtuar Drejtorise se Urbanizmit dhe ne shkresen time te pare te dates 12 nentor 2019.

Une i kam uruar disa here verbalisht, me email dhe me SMS Investitoreve te Kompanise 'Albing - B' dhe ish fqinjëve qe te realizojne Projektin e tyre me sukses ne pjesen e eperme mirepo per pjesen tone sic e kam potencuar ne shkrese zyrtare por edhe atyre verbalisht dhe me email disa here rradhazi mund te behet vetem me miresjellje duke e diskutuar dhe negociuar Oferten tone te shitjes dhe Jo me presion psikologjik duke larguar 3 familje qe rrethojne dy shtepite tona ne menyre qe te ndihemi te pasigurte ngase eshte nje ambient dhe mjedis i rrezikshem.

Sidoqofte, une kam vendosur kamera, alarm dhe pajisje tjera te sigurise duke perfshire 'vezhgimet' dhe ofruesit e sigurise qe te parandalohen aktet kriminale ndaj familjes sone prej paleve te treta ne bashkepunim me organet publike gjegjese te Republikes se Kosoves ku personat qe mund te ndermarrin akte te tilla dhe porosiste e tyre te marrin denimin e rende dhe te merituar.

Me daten 06 korrik 2018, ora 13.25 pm, me email drejtuar Znj. Nazife Krasniqi dhe Znj. Mimoza Prestreshi, kam derguar kundershtimet e mija ligjore qe nese fillojne rrenimet e shtepive te familjes Krasniqi, Zeneli dhe familjes Gashi, do te kundershtojte ligjerisht cdo leje ngase rrezikojne strukturen e 2 shtepive tona dhe mungeses se sigurise per shkak te konstalacionit gjeografik.

Ne kete drejtim, **shih te printuar dhe te bashkengjitur kete email** ku kerkoje nga Autoriteti i juaj qe te publikoni ne portalin e Komunes ku eshte publikuar Vendimi per dhenien e kushteve ndertimore per Investitorin 'Albing - B', te dates 18.07.2019 dhe Lejen e rrenimit ne zonen e caktuar te projektit ne fjale.

Kerkoje nga Autoriteti i juaj qe te i drejtoheni Departamentit te Teknologjise te Komunes se Prishtines qe te vertetojne ne Serverin e Emailit te Komunes se ky kundershtim/ankese/koment i imi eshte derguar dhe pranuar nga zyrtaret komunal me daten 06 korrik 2018, ora 13.25 pm dhe nuk eshte i vertete pohimi i pa-argumentuar, i pa baze, pa fakte qe Drejtoria e Urbanizmit nuk ka pranuar kete email tim kundershtues.

Une e kam verejtur ne Portalin e Komunes se Prishtines ku jane te publikuar Vendimet per Kushtet Ndertimore qe jane te publikuara ne PDF version kundershtime dhe peticione te banoreve te ndryshem te Prishtines per projektet te ndryshme dhe te njeften kundershtim qe kam bere me daten 06 korrik 2018, ora 13.25 pm, te skenoni dhe te publikoni ne te njeften link ngase cdo kundershtim qe bejne banoret duke perfshire edhe mua duhet te trajtoni ne menyre te barabarte dhe te publikoni ne Portalin e Komunes se Prishtines.

Ju theksuat se nuk e keni pranuar kundershtimin tim me email te dates 06 korrik 2018, ora 13.25 pm, edhe pse nuk keni ofruar asnje deshmi bindese teknike, teknologjike dhe ligjore por mos pranim te emailit tim por ky eshte vetem nje pohim bosh dhe i pabaze per mos pranim te emailit tim.

Megjithate, une e kam derguar emailin sic mund te vereni dhe kerkoje **qe kete email te skenoni dhe ne PDF version te publikoni ne portalin e Komunes ku publikohen Vendimet per Kushtet Ndertimore ose te beni ndryshimin e Vendimit per dhenien e Kushteve Ndertimore per firmen 'Albing - B'** duke e potencuar kundershtimin tim mirepo pa prekur ne permbatjen e saj.

Kur te publikoni 'emailin tim' ose te beni ndryshimin e caktuar ligjor ne vete Vendimin per Kushtet Ndertimore dhe te publikoni ne portalin e Komunes se Prishtines, ju lutem, te me njoftoni zyrtarisht nepermjet shkreses zyrtare ne adresen time postale, ashtu sic keni derguar shkresen tuaj te dates 19.11.2019 ose ne emailin tim: fitimv@gmail.com

Nese **nuk e publikoni kundershtimin tim qe kam bere me email te dates 06 korrik 2018, ora 13.25 pm**, qe kam bere ankese/koment duke respektuar afatin ligjor i dhene nga vete Komuna e Prishtines gjate vitit 2018, sic ka bere ankese edhe Zt. Ibrahim Sejdiu dhe Zt. Lulzim Sejdiu, qe po e kerkoje tash me kete Leter Zyrtare ngase po pohoni pa baze dhe pa fakte qe nuk keni pranuar emailin tim ne vitin 2018 atehere **ligjerisht konstatohet se Znj. Nazife Krasniqi, qe eshte pergjegjese per leshimin e kushteve ndertimore per firmen 'Albing - B' por edhe stafi tjeter pergjegjes ne Drejtorine e Urbanizmit qe eshte involvuar ne kete projekt, e favorizoni ne maksimum firmen 'Albing - B' duke me diskriminuar rende mua dhe familjen tone si pale kundershtuese.**

Besoje se nuk ka nevojte te ju tregojte qe diskriminimi i hapur per nje pale dhe favorizimi i pales tjeter eshte veper penale dhe akt i denueshem sipas ligjeve ne fuqi ne Republiken e Kosoves.

Edhe njehere po e perserise sic e kam e potencuar edhe ne letren zyrtare te dates 12 nentor 2019, se si qytetar i interesuar dhe i prekur drejtperdrejte ne realizimin e ketij Projekti, nepermjet e-mailit, kam ofruar mendimet e mija dhe kundershtimet qe poqese fillon realizimi i ndertimit ne parcelat ku jane dy shtepite tona dhe rrezikohet struktura por edhe siguria nga dhenia e lejes ndertimore Investitorit te potencuar me larte do te kundershtojte ligjerisht dhe do te ndjeket penalisht cdo person ose zyrtar publik ose person fizik ose person juridik per demin qe mund te na shkaktohet nga ngjarjet ne dy shtepite tona per shkak te mungeses se sigurise ose rrezikimit te struktures.

Ne vendimin per dhenien e kushteve ndertimore ceken kundershtimet e Zt. Ibrahim Sejdiu dhe Zt. Lulzim Sejdiu mirepo **nuk ceken edhe kundershtimet e mija qe kam dorezuar me email zyrtareve te Drejtorise se Urbanizmit** ne kohen kur zyrtaret pergjegjes komunal te Drejtorise se Urbanizmit kane vendosur Shpallje ne Lagje.

Vetvetiu kjo eshte nje tregues ligjor qe Drejtoria e Urbanizmit te Komunes se Prishtines **eshte duke e favorizuar Investitorin** duke e fshehur informacionin ne Vendimin e saj te dates 18.07.2019.

Ne qoftese se **ndodh prej ketij momenti ndonje akt ndaj familjes sone; ndaj anetareve te familjes sone; ndaj 2 shtepive tona ose ndaj shtepive dhe familjeve tjera per shkak mungeses se sigurise ngase 3 familjet e lartepemendura ne menyre te koordinuar kane leshuar shtepite e tyre me perkrahjen e firmes 'Albing - B' e qe nuk jane zyrtarisht pjese e Projektit**, ashtu sic e pershkrova me larte ateher te gjitha **personat e involvuar do te konsiderohen pergjegjes per ngjarjen e tille dhe do te ndjeken penalisht nga institucionet publike / gjyqesore te Republikes se Kosoves** dhe do bejne kompenzimin e demit material dhe financiar.

Pres qe kur te leshoni Lejen Ndertimore per Investitorin 'Albing - B' ose mund te shkarkoje kete leje ndertimore nga Portali por pres qe te me njoftoni zyrtarisht dhe te me ofroni Kopjen Komplete te Lejes Ndertimore ngase **prekem si pale e interesuar nga realizimi i ketij Projekti** per te konstatuar ligjerisht nese kjo Leje Ndertimore eshte dhene ne pajtim me te gjitha ligjet ne fuqi ne Republikën e Kosoves nga zyrtaret pergjegjes te Komunes se Prishtines.

Sic kam potencuar ne shkresen e pare te dates 12 nentor 2019, edhe njehere e perserise se per cdo rrezik dhe dem qe i shkaktohet familjes sone per shkak se 3 familje qe nuk jane zyrtarisht pjese e projektit ne te njejten kohe ne menyre te koordinuar kane leshuar shtepite e tyre dhe per kete shkak eshte rritur pasiguria dhe per cdo rrezik qe mund te na shkaktohen ne te ardhmen do te pergjigjen ligjerisht si zyrtaret e Departamentit te Urbanizmit por edhe te gjitha personat tjere te involvuar te Investitorit.

Cdo refuzim per ofrimin e kopjes se lejes ndertimore per Investitorin 'Albing - B' eshte i paligjshem dhe kunderligjor dhe i njejti refuzim do te klasifikohet si abuzim me detyren dhe pushtetin publike duke e konsideruar te njejten si akt te denueshem qe do te njoftohen organet me te larta publike dhe gjyqesore.

Shih te **bashkengjitur kopjen e emailit te dates 06 korrik 2018, ora 13.25 pm**, qe kam bere kundershtimin tim ne kuader te afatit ligjor por qe zyrtaret (*Nazife Krasniqi dhe Mimoza Prestreshi*) e Drejtorise se Urbanizmit per nje **'arsye te caktuar subjektive ose me qellim favorizimi per firmen 'Albing - B'** kane harruar te potencojne kundershtimin tim ne Vendimin per Dhenie te Kushteve Ndetimore per firmen 'Albing - B' por qe tash kane obligim ligjor te njejten te publikojne ne Portalin e Komunes se Prishtines ne te njejten link ku publikohen keto Vendime per Kushte Ndertimore ose te beje Amamentim te Vendimit te Kushteve te Ndertimore per firmen 'Albing - B' ne menyre qe edhe une si kundershtues te trajtohem ne menyre te barabarte si kundershtimi i Zt. Ibrahim Sejdiu dhe Zt. Lulzim Sejdiu, qe kundershtimet e tyre kane qene te cekura dhe te potencuara ne Vendimin ne fjale.

Tash nuk mundeni te kundershtoni publikimin e ketij emaili tim ngase kam derguar ne afatin e kerkuar ligjor dhe pres e njejta te publikohet dhe te informohem per publikimin e se njejtes ne portalin e Komunes, ashtu sic keni skenuar dhe publikuar kundershtimet e banoreve te tjere te Komunes se Prishtines per kundershtimet e tyre ne projekte te ndryshme.

Une kete kundershtimin tim te dates 06 korrik 2018, ora 13.25 pm, me kerkesen e Zt. Ibrahim Sejdiu, ja kam forwarduar/derguar edhe Zt. Ibrahim Sejdiu dhe Zt. Lulzim Sejdiu.

